INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS

Tenderët për riparime kapitale në KEK, peng i kontratave të viteve 70-ta

INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS

Tenderët për riparime kapitale në KEK, peng i kontratave të viteve 70-ta

COPYRIGHT © 2019. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.
Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 38,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

PËRMBAJTJA

6 Hyrje

8 Përmbledhje Ekzekutive

10 Kontratat e dhëna me procedurë të negociuar (një-burimore) gjatë viteve 2018, 2017 dhe 2016 nga Korporata Energjetike e Kosovës

11 Kompanitë më të shpërblyera me kontrata përmes procedurës me negocim pa publikim të njoftimit për kontratë gjatë viteve 2018, 2017 dhe 2016 nga Korporata Energjetike e Kosovës

12 Monitorimi i tre tenderëve "me procedurë të mbyllur me negocim"

13 Zhvillimi i negocimeve me operatorët ekonomik

14 Remonti kapital i turbinës së Bllokut B1

17 Riparim Emergjent i Gjeneratorit Elektrik në TC Kosova B

19 Puna për riparimin e turbinës në bllokun B2

21 Rekomandimet

HYRJE

Kontratat e prokurimit publik përbëjnë një pjesë të madhe të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe të shpenzimeve publike të çdo vendi, dhe si të tilla paraqesin një pikë shumë të ndjeshme dhe të ekspozuar ndaj manipulimeve dhe keq menaxhimeve. Kontratat publike shfrytëzohen për blerjet më të ndryshme për nevoja të publikut, duke filluar nga një laps i thjeshtë apo uji të pijshëm, e deri te ndërtimi i autostradave apo kontraktimi i shërbimeve të ndjeshme shtetërore. Si të tilla gjenerojnë një qarkullim të madh të parasë, dhe nëse janë të menaxhuara mirë, janë një indikator kyç në zhvillim e sektorit të biznesit.

Në vitin 2017, hisja e prokurimit publik në Bruto Produktin Vendor (BPV) e Kosovës arriti në 7.35 %, me vlerë prej 459.7 milionë eurosh. Prej këtyre mjeteve, 87% janë kontraktuar përmes procedurës së hapur. Sidoqoftë, 98% e kontratave publike janë dhënë sipas kriterit të çmimit më të ulët, e jo sipas raportit më të mirë çmim/cilësi. Një menaxhim i dobët i prokurimit publik parandalon zhvillimin e mirëfilltë të konkurrencës së tregut, duke krijuar kështu mundësi favorizuese për operator ekonomik të caktuar. Më tepër, duke paguar më shtrenjtë për shërbimet dhe mallrat sesa që janë në tregun me pakicë, humb "vlera për paranë", respektivisht rriten shpenzimet publike dhe duke ndikuar negativisht në burimet, apo investimet e kthyera nga Qeveria për tatimpaguesit.

Sigurimi i çmimeve më të favorshme dhe kursimi i parasë publike vetëm, nuk e garantojnë vlerën për paranë, pa një monitorim efektiv të zbatimit të kontratave publike. Vetëm duke kryer një monitorim sistematik dhe efikas do të mund të parandalohet keq-menaxhimi, korrupsioni dhe do të sigurohej që sjellja e korruptuar të ekspozohet dhe sanksionuar siç duhet.

Monitorimi 8-vjeçar i prokurimit publik në nivel qendror dhe lokal nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), i nxjerr në pah arsyet pse ky sektor është më i prirur për korrupsion dhe keq-menaxhim. Arsyet kryesore janë: dispozitat ligjore të pamjaftueshme, mungesa e trajnimeve adekuate për stafin e prokurimit publik, planifikimet e dobëta publike, mungesa e vullnetit të mirë dhe integritetit të zyrtarëve kyç në vendimmarrje,konkurenca jo e drejtë, mungesa e transparencës dhe llogaridhënies institucionale e posaçërisht mosndëshkueshmëria e akterevë të përfshirë në korrupsion e keq-menaxhim.

Ky hulumtim flet për aktivitetet e prokurimit në Korporatën Energjetike të Kosovës sh.a që është ndërmarrja kryesore energjetike në Republikën e Kosovës, asetet e të cilës janë nën pronësi të plotë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Funksion parësor i Korporatës është prodhimi i qymyrit dhe gjenerimi i energjisë elektrike përmes dy termocentraleve Kosova A dhe Kosova B[1]. Meqenëse KEK është kompani me pronësi publike, të gjitha blerjet e saj duhet ti nënshtrohen Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë. KEK është institucioni me pjesëmarrjen më të madhe monetare në shpenzimet totale të prokurimit publik në Kosovë. Në vitin 2017 KEK kishte shpenzuar përmes prokurimit publik 69,359,172.67 Euro apo 15.08% të vlerës totale të kontratave publike të nënshkruara në Kosovë[2].

Në vitin 2018 kontratat më të mëdha të dhëna nga KEK ishin për investimet kapitale, repsektivisht riparime të pajisjeve - turbinave dhe gjeneratorëve në termocentralin Kosova B me qëllim të sanimit të dëmtimeve si dhe shtimit të jetëgjatësisë së pajisjeve, përkundër faktit që këto pajisje janë afër përfundimit të jetëgjatësisë së tyre dhe rëndësia e kryerjes së këtyre kontratave me sukses është shumë e madhe duke ditur që termocentrali Kosova B është furnizuesi kryesorë me energji elektrike në Kosovë.[3]

KDI duke analizuar procedurat e tenderimit dhe dhënies së tre kontratave për riparime të gjeneratorit dhe turbinave në termocentralin Kosova B në KEK, ka nxjerrë disa gjetje mbi bazën e të cilave ofron rekomandime që i shërbejnë përmirësimit të politikave dhe praktikave aktuale të prokurimit në Korporatën Energjetike të Kosovës.

1 http://kek-energy.com/kek/profili-i-kek-ut/
2 Raporti mbi Aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë për vitin 2017
3 Intervistë nga takimi me zyrtarët e KEK, 20.03.2019

Në vitin 2017, hisja e prokurimit publik në Bruto Produktin Vendor (BPV) e Kosovës arriti në 7.35 %, me vlerë prej

459.7 milionë eurosh

Në vitin 2017 KEK kishte shpenzuar përmes prokurimit publik

69,359,172.67 Euro apo 15.08%

të vlerës totale të kontratave publike të nënshkruara në Kosovë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport paraqet rezultatet e hulumtimit, të procesit të dhënies së 3 kontratave për riparime të turbinave dhe gjeneratorit në termocentralin Kosova B, të dhëna me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratat.

Gjatë vitit 2018, KEK kishte shfrytëzuar "procedurën e mbyllur me negocim" në dhënien e kontratave publike në masën prej 27% të vlerës totale të kontratave apo 17,234,732.36 Euro. Kjo njëherit ishte edhe vlera më e madhe e dhënë në tre vitet e fundit sipas procedurave të mbyllura me negocim.

Kjo vlerë e madhe e prokurimeve të KEK-ut ,e realizuar sipas procedurës së negociuar, pa publikim të njoftimit (e njohur si procedurë një burimore) ka qenë pikërisht arsyeja pse KDI kishte përzgjedhur këta tenderë për monitorim.

Qëllimi i hulumtimit ka qenë vlerësimi i domosdoshmërisë së përdorimit të kontratave të negociuara nga KEK-u, a janë zhvilluar këto procedura në përputhje me ligjet e prokurimit publik, mënyrat e zhvillimit të negocimit të KEK-ut me operatorët ekonomik, e sidomos negocimi me operatorët të cilët mund të kenë monopol në ofrimin e këtyre shërbimeve apo furnizimeve.

KDI ka analizuar 3 kontrata të mëdha për riparime të turbinave dhe gjeneratorëve të cilat janë dhënë me procedurë të negociuar dy operatorëve ekonomik GE Power dhe Alstom Power Services. Këta operatorë ekonomik edhe pse janë entitete të ndara, realisht janë kompani të lidhura pasi GE Power ka në pronësi kompaninë Alstom Power Services. Këto dy kompani gjatë 3 viteve të fundit 2018, 2017 dhe 2016 së bashku kishin përfituar kontrata nga KEK në vlerë prej mbi 22 milion Euro. Të gjitha këto kontrata këtyre kompanive i ishin dhënë përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimi – procedurë jo e hapur ndaj tregut.

Në bazë të ligjit për prokurim publik procedurat e negociuara duhet të përdoren vetëm në raste të caktuara kur ekziston vetëm një operatorë ekonomik që mund të kryej shërbimet apo në rastet e urgjencave ekstreme si dhe nëse vendoset për shfrytëzimin e këtyre procedurave, atëherë autoritetet kontraktuese duhet të bëjnë analiza të tregut në mënyrë që të identifikojnë operatorët adekuatë dhe t'i ftojnë ata për negocim. Procesi i negocimit duhet t'i sigurojë autoritetit kontraktues të arrijnë vlerën më të mirë për paranë e shpenzuar.

KEK gjatë planifikimit të këtyre prokurimeve nuk kishte bërë një hulumtim të tregut për të identifikuar nëse tregu ofron operatorë ekonomik që ofrojnë këto shërbime. Përkundrazi, KEK kishte dërguar kërkesë për ofertë vetëm tek kompania GE Power, me arsyetimin që kompania GE Power është trashëguese e teknologjisë së prodhuesit fillestar të këtyre pajisjeve dhe vetëm kjo kompani mund të kryejë shërbimet e remonteve të turbinave dhe gjeneratorëve.

Nëse KEK paraprakisht do të kishte kryer një hulumtim më të detajuar të tregut apo do t'a konsideronte shpalljen publike të njoftimit për kontratë, atëherë do t'a kishte një pasqyrë reale mbi ekzistencën e kompanive tjera që ofrojnë shërbimet e kërkuara në treg dhe mbi çmimet e tregut për këto shërbime.

Gjithashtu publikimi i njoftimit për kontratë do të mund të stimulonte një konkurrencë të shëndoshë e cila do të bënte presion mbi ofertuesit për të ofruar çmime dhe kushte më të favorshme.

Edhe nëse ekziston vetëm një kompani e cila ofron këto shërbime, atëherë KEK do të mund të kishte aplikuar metoda të tjera[4] për të siguruar çmime sa më të arsyeshme. Në bazë të RrUOPP[5], në rastet kur ekziston vetëm një furnizues dhe kur nuk ka

4 Harvard Business Review – How to negotiate with powerful suppliers – 07.2015
5 Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik nga KRPP

alternative të tjera, atëherë autoriteti kontraktues duhet të sigurohet se çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut. KEK gjatë vlerësimit të ofertave, nuk kishte krahasuar çmimet e ofertës me ndonjë burim tjetër ku do të mund të vërtetohej se operatori ekonomik nuk ofron çmime më të larta sesa për termocentralet të tjera të rajonit.

Me qëllim të sigurimit të çmimeve dhe kushteve më të favorshme kontraktuale, KEK duhet të sigurohet që para caktimit të procedurës së prokurimit të bëjë hulumtim të tregut për të përcaktuar vlerën e parashikuar të kontratës dhe operatorët ekonomik potencial për ofertim. Të shqyrtoj mundësinë e shfrytëzimit të procedurës së hapur të prokurimit tek kontratat që deri më tani janë dhënë me procedura të negociuara. Duke u bazuar në vlerat e larta të kontratave një burimore të dhëna, KEK duhet të angazhohet në krijimin e kapaciteteve profesionale për zhvillimin e procedurave të prokurimit të negociuara: si në përgatitjen e stafit teknik të mjaftueshëm dhe kompetent që do të mundësonte vlerësimin e punimeve të nevojshme si dhe vlerësimin teknik të ofertave nga OE si dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit të prokurimit që do të specializoheshin në zhvillimin e negociatave me operatorët ekonomik.

Qëllimi i hulumtimit ka qenë vlerësimi i domosdoshmërisë së përdorimit të

kontratave të negociuara nga KEK-u,

a janë zhvilluar këto procedura në përputhje me ligjet e prokurimit publik, mënyrat e zhvillimit të negocimit të KEK-ut me operatorët ekonomik, e sidomos negocimi me operatorët të cilët mund të kenë monopol në ofrimin e këtyre shërbimeve apo furnizimeve.

KDI ka analizuar

3 kontrata të mëdha për riparime të turbinave dhe gjeneratorëve

të cilat janë dhënë me procedurë të negociuar dy operatorëve ekonomik GE Power dhe Alstom Power Services.

Këto dy kompani gjatë 3 viteve të fundit 2018, 2017 dhe 2016 së bashku kishin përfituar kontrata nga KEK në vlerë

prej mbi 22 milion Euro

Kontratat e dhëna me procedurë të negociuar (një-burimore) gjatë viteve 2018, 2017 dhe 2016 nga Korporata Energjetike e Kosovës[6]

	2018	2017	2016
Vlera totale e kontratave të nënshkruara nga KEK	62,993,706.38	69,321,727.23	38,931,163.04
Vlera totale e kontratave të nënshkruara me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit	17,234,732.36	11,638,958.94	3,222,852.47
Përqindja e pjesëmarrjes së kontratave me procedure të negociuar në vlerën totale të kontratave të nënshkruara	**27%**	**17%**	**8%**
Përqindja e përgjithshme në prokurim publik në Kosovë e dhënies së kontratave përmes procedurave të negociuara pa publikim të njoftimit		9%	12%

Në vitin 2018, KEK, përmes procedurave të mbyllura të prokurimit kishte nënshkruar kontrata në vlerë prej mbi 17 Milion Euro apo 27% të totalit të kontratave të dhëna. Një arsye se përse vlera e kontratave të nënshkruara përmes procedurave të negocimit gjatë vitit 2018 ishte kaq e lartë ishte edhe nënshkrimi i kontratave me vlerë mbi 3 Milion Euro me kompanitë publike për furnizim me ujë ku çmimi i tregut është i përcaktuar nga rregullatori. Mirëpo edhe pa përfshirjen e këtyre kontratave, në vitin 2018 kishte një rritje prej 5% në dhënien e kontratave përmes procedurës së negociuar krahasuar me vitin 2017.
Në vitin 2017, KEK, përmes procedurave të mbyllura të prokurimit kishte nënshkruar kontrata në vlerë prej 11.6 Milion Euro apo 17% të totalit të kontratave të dhëna ishin dhënë përmes procedurës një burimore. Kjo është sa dyfishi i përqindjes të kontratave të dhëna me procedurë të negociuara në nivel vendi.
Në vitin 2016, KEK, përmes procedurave të mbyllura të prokurimit kishte nënshkruar kontrata në vlerë prej 3.2 Milion Euro apo 8% të totalit të kontratave të dhëna.

6 Raportet vjetore të prokurimit publik të KEK për vitet 2018, 2017 dhe 2016

5 kompanitë më të shpërblyera me kontrata përmes procedurës me negocim pa publikim të njoftimit për kontratë gjatë viteve 2018, 2017 dhe 2016 nga Korporata Energjetike e Kosovës[7]

2018		2017		2016	
GE POWER	4,759,020	GE POWER	10,481,944	ALSTOM POWER SERVICE	2,111,792
ALSTOM POWER SERVICE	4,450,056	ALSTOM POWER SERVICE	505,113	EX FIS	605,730
IBËR LEPENC	2,000,700	AUTOTRAN SPORTI	442,500	REPLAN	124,137
RUDARSKI INSTITUT D.O.O	1,117,000	ELDI-COM	147,232	GE POWER	115,000
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL "PRISHTINA"SH.A.	1,002,528	S&P Global PLATTS	21,950	PASTRIMI	99,554
	13,329,304		**11,598,739**		**3,056,213**

Nga tabelat e mësipërme shihet se në tre vitet e fundit, shumica e kontratave të dhëna me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë i janë dhënë dy kompanive: GE Power dhe Alstom Power Services, kompani të cilat ofrojnë shërbime të riparimit dhe furnizimit me pjesë rezervë për riparimet të pajisjeve të Korporatës Energjetike të Kosovës.
GE Power, gjatë viteve 2018, 2017 dhe 2016 ishte shpërblyer me kontrata publike në vlerë prej 15,355,964 Euro, të gjitha këto kontrata të dhëna përmes procedurave të mbyllura pa publikim.
Alstom Power Service gjatë viteve 2018, 2017 dhe 2016 ishte shpërblyer me kontrata publike në vlerë prej 7,066,961 Euro, të gjitha këto kontrata ishin dhënë përmes procedurave të mbyllura pa publikim.
GE Power dhe Alstom Power Services janë kompani të lidhura, GE Power ka në pronësi kompaninë Alstom Power Services, kjo vërtetohet edhe në kontratat e nënshkruara nga këto kompani, ku i njejti person është përfaqësues i të dy kompanive.

7 Raportet vjetore të prokurimit në KEK 2018, 2017 dhe 2016

MONITORIMI I TRE TENDERËVE "ME PROCEDURË TË MBYLLUR ME NEGOCIM"

KDI ka analizuar tre kontratat e mëposhtme, të dhëna nga KEK, përmes shfrytëzimit të procedurës së prokurimit me negocim pa publikim të njoftimit. Kontrata për Remontin Kapital të Turbinës së Bllokut B1 dhe kontrata për Riparim Emergjent i Gjeneratorit Elektrik në termocentralin Kosova B, ishin nënshkruar dhe përfunduar punimet në vitin 2018, ndërsa kontrata; Puna për Riparimin e Turbinës në Bllokun B2 ishte dhënë në vitin 2019 dhe në datën e këtijë raporti ende nuk ishte përfunduar.

Kontrata	Operatori Ekonomik i kontraktuar	Vlera e kontratës së nënshkruar	Lloji i Procedurës së prokurimit
Remonti Kapital i Turbinës së Bllokut B1	GE Power & Alstom Power Service	**4,759,020.24 Euro**	Procedurë e mbyllur me negocim
Riparim Emergjent i Gjeneratorit Elektrik në TC Kosova B	Alstom Power Service	**2,915,227.00 Euro**	Procedurë e mbyllur me negocim
Puna për Riparimin e Turbinës në Bllokun B2	GE Power & Alstom Power Service	**4,083,925.00 Euro**	Procedurë e mbyllur me negocim

ZHVILLIMI I NEGOCIMEVE ME OPERATORËT EKONOMIK

Kontrata	Oferta financiare fillestare nga operatori ekonomik	Zbritja e kërkuar nga KEK në negociim	Zbritja e pranuar nga OE
Remonti Kapital i Turbinës së Bllokut B1	**4,326,821.00 Euro**	7 % nga çmimi bazë i ofertës	**148,000.00 Euro**
Riparim Emergjent i Gjeneratorit Elektrik në TC Kosova B	**2,915,227.00 Euro**	Është kërkuar zbritje nga KEK pa specifikuar detajet e kësaj zbritje në raportin e negociatave	**Zero**
Puna për Riparimin e Turbinës në Bllokun B2	**4,083,925.00 Euro**	Është kërkuar zbritje nga KEK pa specifikuar detajet e kësaj zbritje në raportin e negociatave	**Zero**

Nga vlerësimi i procesit të zhvillimit te negociatave nga KEK dhe operatorët ekonomik për tre kontratat si më lartë, vërehet se vetëm në kontratën e parë për Remontin Kapital të Turbinës së Bllokut B1, KEK ka arritur që të përfitoj zbritje në çmim nga oferta fillestare e dorëzuar nga operatori ekonomik.

REMONTI KAPITAL I TURBINËS SË BLLOKUT B1

Planifikimi i Prokurimit

KEK, fillimisht kishte planifikuar remontin kapital të turbinës në Bllokun B2 për të cilin kishte kryer të gjitha procedurat e prokurimit deri te nënshkrimi i kontratës, mirëpo për shkak të defekteve të hasura në turbinën e bllokut B1, menaxhmenti kishte vendosur që kontrata e nënshkruar për riparim të turbinës në bllokun B2 të shfrytëzohet për riparimin e bllokut B1. Kjo është bërë përmes amandamentimit të kontratës me numër 4657 të datës 18 Qershor 2018 ku është ndryshuar objekti i kontratës.

Remonti i fundit kapital i turbinave është bërë në vitin 2011, dmth 7 vite më parë. Bazuar në përvojat e kaluara, remontet do të duhej të bëheshin çdo 5-6 vite. Shtyrja e afatit ne 7 vite ka ndodhur si pasojë e pritjes së projektit të fizibilitetit dhe shikimit të mundësisë së përfshirjes së më shumë projekteve në të njëjtën kohë.[8]

Specifikimet teknike për këtë kontratë ishin përgatitur nga kompania GE Power pas vlerësimit të punëve të nevojshme në këtë stabiliment. Në pyetjen nga KDI, se pse e njejta kompani që kryen punimet, përgatitë specifikimet teknike, KEK është përgjigjur: KEK nuk ka kapacitete për hartimin e specifkimeve teknike për shkak të kompleksitetit të pajisjeve dhe rrezikut të dështimit të punimeve nga mos përgatitja adekuate e specifikimeve teknike.[9]

Me datën 16.01.2018, KEK ka dërguar në KRPP njoftimin për përdorim të procedurës së negociimit, në të cilin janë dhëne arsyet e shfrytëzimit të kësaj procedure ashtu siç kërkohet edhe me rregullat e LPP. Arsyetimi i KEK lidhur me këtë procedurë është që "*General Electric (ish Alstom-i, respektivisht ish MAN) është kompania e vetme e ftuar për dorëzim të ofertës, për shkak se është trashëgues i teknologjisë dhe njohurive (know-how) për këtë stabiliment si prodhues origjinal i pajisjeve (OEM) dhe askush nuk ka aftësinë dhe pronësinë intelektuale dhe inxhinierie për ekzekutimin e punëve në një stabiliment të tillë si prodhuesi origjinal",* mirëpo pas këtijë pohimi nuk qëndron një hulumtim i tregut i cili do të mund të evidentonte pohimin se në treg ekziston vetëm një kompani që kryen këto shërbime.

8 Njoftim pwr Komisionin Rregullativ tw Prokurimit Publik, 15.01.2018, KEK
9 Intervistë me Drejtorin Ekzekutiv tw Termocentralit Kosova B, z.Luigj Imeri, 20.03.2019, Prishtinw

Vlerësimi i ofertave dhe zhvillimi i negociatave

Pas vlerësimit të punimeve të nevojshme nga GE Power, KEK kishte kërkuar ofertë nga OE GE Power. Me 28.03.2018, KEK ka pranuar ofertën nga konzorciumi Alstom Power Services - Francë dhe GE Power AG - Gjermani në vlerë totale prej 4,370,386 Euro, me kohëzgjatje të punëve deri në përfundim të kontratës prej 82 ditësh.

Kostoja e përgjithshme e ofertës për punën për riparim të turbinës në bllokun B2 është si në vijim:

- Kostoja bazë e punës për riparim të turbinës 3,223,026.00 Euro dhe totali i kostove opsionale për aktivitete të ndryshme është ofertuar 480,691.00 Euro. Totali i ofertës së ofertuar pa TVSH 3,703,717.00, kurse totali i ofertës me TVSH ishte 4,370,386.06 Euro.
- Kohëzgjatja e planifikuar e riparimit kapital të turbinës është paraparë të jetë 82 ditë.

Komisioni për zhvillimin e negociatave i KEK, i përbërë nga 5 persona, i themeluar për zhvillimin e neogicmeve me operatorin ekonomik ka mbajtur takimin e parë me datë 28.03.2018 me përfaqësuesit e OE Alstom Power Services dhe GE Power Services ku janë diskutuar termet dhe kushtet e kontratës si stafi që do të angazhohet, organizimi i punëve në vend, materialet shpenzuese, kushtet e pagesës etj.

Komisioni për zhvillimin e negociatave kishte kërkuar nga OE që në ofertën e operatorit ekonomik të përfshihen edhe disa kosto shtesë opsionale si dhe përfshirjen e kostove për sjelljen e dy kranistëve për kryerjen e punimeve, pasi KEK nuk kishte kapacitete njerëzore.

Me datë 6 Prill, 2018, OE kishte dorëzuar ofertën e reviduar sipas kërkesave të KEK, ku kosto bazë e kontratës nga 3,223,026 Euro ishte ngritur në 3,435,290 Euro. Rritja e kostos për 212,264 Euro paraqet koston shtesë, dy kranista të kërkuara nga KEK në vlerë prej 137,971 Euro dhe pjesa tjetër 74,293 Euro paraqet kosto shtesë të logjistikës.

Kosto opsionale gjithashtu ishte ngritur nga 480,691 Euro në 891,531 Euro. Diferenca prej 410,840 paraqet: Kostot Opsionale (take-out price) prej 321,101 Euro për dy javë të qëndrimit të personelit të OE në TC Kosova B në rast të zgjatjes eventuale te remontit të turbinës B2 prej afërsisht dy javë. Pjesa tjetër prej 89,739 Euro paraqet kostot shtesë opcionale të kërkuara nga KEK.

Vlera totale e kontratës pas ofertës së reviduar kishte arritur në 4,326,821.0 Euro pa tvsh, ndërsa me tvsh të përfshirë vlera totale arrinte në 5,105,648.78 Euro.

Vlen të theksohet se plani i pagesave kishte ndryshuar në ofertën e reviduar si pasojë e kërkesës nga KEK për ndryshim të planit të pagesave.

Me datë 11 Prill 2018, komisioni i KEK ishte mbledhur për të shqyrtuar ofertën e reviduar, ku drejtori ekzekutiv i KEK, kishte njoftuar komisionin se nga oferta duhet të kërkohet të largohet pozicioni për dy kranistë pasi KEK kishte siguruar këtë personel në mënyra tjera.

KEK, kishte kërkuar nga OE që në kostot e kontratës të heqë kostot e disa pjesëve rezervë të cilat ishin në depo, OE kishte pranuar këtë kërkesë duke reduktuar kontratën për pozicionet në lidhje me këto pjesë rezervë në vlerë prej 59,861.40 Euro.

KEK, kishte kërkuar nga operatori ekonomik një zbritje prej 7% nga çmimi bazë i kontratës. OE nuk kishte pranuar këtë zbritje, duke ofruar një zbritje prej 1% apo 51,056.48 Euro, pasi që në një kontratë të mëhershme për riparim të gjeneratorëve kishte ofruar këtë zbritje prej 1%. KEK nuk kishte pranuar zbritjen prej 1% pasi që kjo kontratë ishte e ndryshme nga kontrata paraprake për riparim të gjeneratorit. KEK kishte kërkuar përsëri një zbritje të çmimit prej 148,000.0 Euro përfshirë TVSH nga kontrata bazë, e cila ishte pranuar nga OE dhe kështu ishin mbyllur negociatat.

Kontrata është e nënshkruar me datë 18 Qershor 2018 me numër 4657, në vlerë totale prej 4,759,020.24 Euro.

Menaxhimi i kontratës

Kontrata për Remontin kapital të turbinës së bllokut B1, është menaxhuar nga menaxheri i kontratës i përcaktuar nga kompania, i cili edhe ka mbikqyrur punimet rreth kontratës. Pas përfundimit të punimeve është caktuar komisioni për pranimin e punëve i përbërë nga tre anëtarë. Në raportin e komisionit për pranimin e punëve për kontratën e amandamentuar "Remonti kapital i turbinës me avull i njësisë B1, konstatohet: "*Komisioni i pranimit të punëve nga data 13.12.2018, pas njoftimit nga projekt menaxheri për kryerjen e punëve ka bërë kontrollimin e punëve të kryera. Me datë 31.12.2018 në raportin për pranimin e punimeve komisioni ka konstatuar Pas përcjelljes së vazhdueshme dhe në fund kontrollimit të punëve të për remontin kapital të turbinës me avull të bllokut B1 në Termocentralin Kosova B, komisioni vërtetoi se punët janë kryer sipas të gjitha pikave të kontratës*"

Me 28.03.2018,
KEK ka pranuar ofertën nga konzorciumi Alstom Power Services - Francë dhe GE Power AG - Gjermani në vlerë totale
prej 4,370,386 Euro,
me kohëzgjatje të punëve deri në përfundim të kontratës prej
82 ditësh.

Vlera totale e kontratës pas ofertës së reviduar kishte arritur në
4,326,821.0 Euro pa tvsh,
ndërsa me tvsh të përfshirë vlera totale arrinte në
5,105,648.78 Euro.

Kontrata është e nënshkruar me datë
18 Qershor 2018 me numër 4657,
në vlerë totale prej
4,759,020.24 Euro.

RIPARIM EMERGJENT I GJENERATORIT ELEKTRIK NË TC KOSOVA B

Planifikimi i prokurimit

Në fillim të muajit Korrik të vitit 2018 gjatë revizionit kur ishte përgatitur të lëshohej për prodhim blloku B1, në fazën startuese të sinkronizimit të gjeneratorit ishte paraqitur alarmi "mbrojtja nga lidhja me tokë e statorit" që pamundësonte sinkronizimin e gjeneratorit. Meqenëse kompania Alstom, veçse ishte angazhuar për punë në bllokun B2 ata së bashku me stafin e TCB-së, kanë analizuar dëmet dhe vlerësuan punën dhe mjetet e nevojshme për këtë riparim. Për shkak të vëllimit të prishjes në zbarat e statorit të gjeneratorit, në pjesën e poshtme dhe në pjesën e sipërme, ishte vërejtur se disa pështjella ishin me defekte serioze, të cilat gjithsesi duhet të ndërroheshin. Këto defekte të identifikuara kërkonin demontimin dhe rimbështjelljen e zbarave të vjetra të cilat ishin të disponueshme në depo të KEK-ut, shqyrtimi i tyre dhe pastaj ri-montimi në vendin e atyre që ishin larguar.[10]

Me datën 16.08.2018 është dërguar në KRPP njoftimi për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Kjo punë e pa parashikuar, si për nga vëllimi, kompleksiteti apo koha e gjatë janë faktor që e bëjnë të pamundur të shkohet me një formë tjetër të prokurimit përveq se me kontratë dhe negocim njëburimorë. Modeli i të pështjellave është i viteve 70ta dhe është shumë e vështirë të gjenden pështjella të tipit të tillë të ngjashme dhe po ashtu ekspertiza e tipave të tillë të gjeneratorëve është e kufizuar. Nese do te porositeshin qe te punohen mbështjellat e reja prodhimi i tyre do te merrte kohe deri në 12 muaj, ku 12 muaj mos prodhim i energjisë do të kushtonte rreth 65.5 Euro (24h*270MW/h*360ditë = 2,332,800MW/h). Keto kane qene argumentet qe kane determinuar qe Menaxhmenti i larte te KEK-ut, vendos pozitivisht ne prokurim një burimor të punës për riparimin e prishjes së statorit të gjeneratorit. GE APS është kompania e cila ka prodhuar pjesët origjinale të gjeneratorëve të TCB andaj është kompania e vetme e cila mund të realizoj këtë punë.

Vlerësimi i ofertave dhe zhvillimi i negociatave

Ma datë 22.08.2018, KEK kishte pranuar ofertën nga GE Alstom Power Services Francë në vlerë prej 2,915,227.00 pa tvsh.

Komisioni për zhvillim të negociatave i KEK-ut ka mbajtur takime me përfaqësuesit e kompanisë GE Alstom France ku janë diskutuar kushtet e kontratës, komisioni kishte kërkuar zbritje të çmimit në disa pozicione mirëpo operatori nuk kishte pranuar uljen e çmimeve me arsyen se ka angazhuar si asnjëher më parë resurset e saja në organizimin e kësaj e oferteve dhe

10 Arsyetimi teknik dhe financiar pwr prokurim njwburimor, 14.08.2018, KEK

organizimin e nënkontraktorëve për kryerjen e këtyre punimeve. Komisioni i negociatave pas vlerësimit të ofertave vjen në përfundim që oferta e GE Alstom France rekomandohet për shpërblim me kontratë për këtë tender.

Për dallim nga zhvillimi i negocimeve në kontratën për remontin e turbinës ku KEK kishte përfituar një zbritje nga çmimi fillestar i ofertuar, në diskutimet e zhvilluara për riparim të gjeneratorit KEK nuk kishte përfituar asnjë zbritje nga çmimi fillestarë.

Kontrata është nënshkruar me datë 03 Shtator 2018 me vlerë totale të kontratës 2,915,227.00 Euro.

Menaxhimi i kontratës

Pas përfundimit të punimeve është caktuar komisioni për pranimin e punëve i përbër nga tre anëtarë.

Komisioni i pranimit të punëve nga data 15.11.2018, pas njoftimit nga projekt menaxheri për kryerjen e punëve ka bërë kontrollimin e e punëve të kryera. Me datë 12.12.2018 në raportin për pranimin e punimeve komisioni ka konstatuar " Me datë 15.11.2018 kanë përfunduar të gjitha punët në riparimin emergjent të statorit në gjeneratorin elektrik të bllokut B1 të parapara me kontratë".

Vlera totale e faturave të lëshuara nga operatori ekonomik deri në përfundim të kontratës ishte 2,915,227.00 Euro, e njejtë me vlerën e kontraktuar.

Ma datë 22.08.2018, KEK kishte pranuar ofertën nga
GE Alstom Power Services Francë
në vlerë prej 2,915,227.00 pa tvsh.

Kontrata është nënshkruar me datë
03 Shtator 2018
me vlerë totale të kontratës
2,915,227.00 Euro.

Vlera totale e faturave të lëshuara nga operatori ekonomik deri në përfundim të kontratës ishte
2,915,227.00 Euro,
e njejtë me vlerën e kontraktuar.

PUNA PËR RIPARIMIN E TURBINËS NË BLLOKUN B2

Planifikimi i prokurimit

Meqenëse paraprakisht gjatë vitit 2018, KEK kishte zhvilluar negociata dhe kishte nënshkruar kontratë për riparimin e turbinës në bllokun B2, mirëpo ishte vendosur që këto punime të kalonin në bllokun B1, të njëjtat kushte dhe çmime të kontratës paraprake ishin shfrytëzuar për të lidhur kontratën e re për punët për riparimin e turbinës në bllokun B2 me operatorin ekonomik Alstom Power Service France dhe GE Power GMBH Germany.

KEK në njoftimin dërguar KRPP për arsyetimin e përdorimit të procedurës me negocim pa publikim të njoftimit për kontratë kishte arsyetuar se General Electric është kompania e vetme e ftuar për dorëzim të ofertes, arsyeja është për shkak se General Electric (ish Alstom-i, respektivisht ish MAN) është trashëgues i teknologjisë dhe njohurive (know-how) për këtë stabiliment si prodhues origjinal i pajisjeve.

Vlerësimi i ofertave dhe zhvillimi i negociatave

KEK kishte kërkuar oferte nga kompania GE Alstom Power Services - GE Power AG, KEK kishte pranuar ofertën në vlere prej 4,033,068 Euro nga konzorciumi Alstom Power Services Frances dhe GE Power Gmbh. Sipas raportit te negociatave: KEK kishte kërkuar zbritje nga çmimi fillestar dhe operatori ekonomik ishte pajtuar të ofroj një zbritje prej 20,000.00 Euro, mirëpo në bazë të ofertës fillestare dhe shtimit të një pozicioni të ri në ofertë në vlerë prej 50,857.00 Euro, del që nuk është ofruar asnjë zbritje nga operatori ekonomik.

Pas negociatave teknike në mes të KEK dhe operatorit ekonomik dhe disa ndryshimeve në pozicione të ofertës, KEK kishte pranuar ofertën e fundit me vlerë totale prej 4,083,925.00.

Kontrata është nënshkruar me datë 21.02.2019, vlera totale e kontratës është 4,083,925.00 Euro.

KEK në njoftimin dërguar KRPP për arsyetimin e përdorimit të procedurës me negocim pa publikim të njoftimit për kontratë kishte arsyetuar se

General Electric është kompania e vetme e ftuar për dorëzim të ofertes, arsyeja është për shkak se General Electric (ish Alstom-i, respektivisht ish MAN) është trashëgues i teknologjisë dhe njohurive (know-how) për këtë stabiliment si prodhues origjinal i pajisjeve.

KEK kishte kërkuar oferte nga kompania GE Alstom Power Services - GE Power AG, KEK kishte pranuar ofertën në vlere prej

4,033,068 Euro

REKOMANDIMET

Rekomandimet për KEK

KEK të kryej hulumtim të tregut ose të shrytëzoj procedurat e hapura tenderuese për të parë nëse ekzistojnë operatorë tjerë ekonomik që ofrojnë këto shërbime. Para dërgimit të ftesës për negocim, sipas kërkesave të RrUOPP[11], KEK duhet të bëjë një analizë të tregut dhe të ftoj operatorët ekonomik adekuat për negocim.

KEK të shqyrtoj mundësinë për lidhjen e kontratave afatgjate për riparime dhe mirëmbajtje të makinerive, pasi lidhja e kontratave afatgjate me furnitorët prej të cilëve është e varur kompania, mundëson ofrimin e çmimeve dhe kushteve më të favorshme.

KEK gjatë negocimit të çmimit me operatorët ekonomik për shërbime të caktuara duhet të kërkojë nga operatori ekonomik të ofrojë kontrata të ngjashme me termocentralet e ndryshme të rajonit me qëllim të krahasimit të çmimeve dhe ofrimit të sigurisë se KEK është duke paguar sipas çmimit të tregut. Për më tepër, KEK duhet të kërkoj sqarime dhe detaje për çmimet e ofruara për secilin nga pozicionet e kontratës, të kërkoj arsyetime për çmimet e ofruara . Pas këtyrë informacioneve të marra KEK do të jetë në pozicion më të mirë për kërkimin e zbritjeve në kontratë.

Meqenëse në të ardhmen KEK pritet të kryejë investime të ngjashme, KEK duhet të investojë në ngritjen e kapaciteteve njerëzore profesionale që do të mund të vlerësonin nevojat për punime, përgatitjen e specifikimeve teknike, negocimin, mbikqyrjen e punimeve etj. KEK sipas modelit të tashëm, e që përbën edhe konflikt interesi, ia ka besuar OE të njejtë edhe të vlerësojë punën e nevojshme që duhet të bëhet, edhe të përgatisë specifikacionet, e mbi të gjithë edhe të kryejë punimet.

KEK, të planifikojë me kohë riparimet dhe investimet me qëllim të shmangies së prokurimeve emergjente dhe nevojave emergjente per punë, pasi këto situata e ulin fuqinë negociuese të KEK përballë operatorëve ekonomik gjatë zhvillimit të negociatave për çmime.

Rekomandimet për KRPP

KRPP të vlerësojë situatat dhe rastet kur autoritetet kontraktuese mund të jenë në një tregu ku ekziston vetëm një furnizues dhe ku e vetmja mënyrë për të siguruar çmime më optimale është nënshkrimi i kontratave afatgjata mbi 36 muaj. KRPP të rishikojë kufizimin ligjor për maksimumin e kohëzgjatjes së kontratave prej 36 muaj dhe për situata të caktuara kur autoritetet kontraktuese do të përfitonin kushte më të mira kontraktuale të i mundësohej lidhja e kontratave mbi 36 muaj.

KRPP të ofroj trajnime për zyrtarët e prokurimit tek autoritetet kontraktuese ku dhënia e kontratave me procedurë të negociuar është e theksuar, me qëllim të aftësimit të zyrtarëve të prokurimit për negocim. Në rastet kur ekziston vetëm një numër i kufizuar i furnizuesve në treg, kushtet dhe çmimet e kontratës janë të varura nga aftësia e ekipit negociues të autoritetit kontraktues për të përfituar çmime të favorshme.

KRPP të angazhohet në monitorimin e prokurimeve me procedurë të negociuar, të vlerësoj arsyeshmërinë e përdorimit të procedurës së negociuar si dhe të vlerësoj procesin e zhvillimit të negocimeve. Të ofroj trajnime për zyrtarët e prokurimit për metodat dhe mënyrat e zhvillimit të negocimeve në mënyrë që AK të përfitojnë kushte kontraktuale sa më optimale.

11 **Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik**

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.
Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni **www.kdi-kosova.org**

Me përkrahjen financiare të:

British Embassy
Pristina